
05-10-2017
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Kadrije Goga-Lubishtani, me sekretaren juridike Florije Jakupi, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED], i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1170-6/16, të dt.16.12.2016, për veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1170-6/16, të dt.16.12.2016 për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.02.02.2017 mori këtë:

AKT GJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1170-6/16, të dt. 16 dhjetor 2016, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri

[REDACTED], nga fshati [REDACTED], Komuna [REDACTED] i lindur me [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

Se me datën 07.07.2016 rreth orës 14.30 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Autoriteti pyjor komunal-Ferizaj, në rajonin ekonomik pyjor Neredime – Jezercë, në vendin e quajtur “Vorret e krushqve”, me qëllim vjedhje me sharrë motorrike ka prerë 1 copë dru të llojit

ahu me dimensione të gjata boniteti III m., me diametër 70 cm., gjithsejtë në kubaturë prej 4.49 m.kub, të cilat i ka bartë me traktor të tipit "Rakovica", vlera e dëmit të shkaktuar është 606.15 €,

-me të cilën ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, t'i paguaj shumën në vlerë prej 606.15 (gjashtëqind e gjashtë euro e pesëmbëdhjetë cent), në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1170-6/16, të dt.16.12.2016 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për veprë penale vjedhje e pylli nga neni 358 par.1, të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr. 1170-6/16, të datës 16.12.2016, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: fletëparaqitjet e rojës së pyllit me vlerësimin dhe llogaritjen e dëmit të pyllit me nr.305/2016 e datës 12.07.2016 vërtetoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform neni 458-459 dhe 460 të KPPK-së obligohet i pandehuri që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, t'i paguaj shumën në vlerë prej 606,15 (gjashtëqind e gjashtë euro e pesëmbëdhjetë cent) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.20/17 datë 02.02.2017

Sekretare juridike

F. Jakupi

Gjyqtarja Individuale

Kadrije Goga-Lubishtani,



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.